

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



LËNDA: BASKETBOLL

**Tema: "PARAQITJA E KARAKTERISTIKAVE NË DISA NDRYSHORE
MORFOLOGJIKE DHE LËVIZORE BAZIKE E SPECIFIKE
NDËRMJET GRUPIT TË DJEMVE DHE VAJZAVE TË MOSHËS 14-15
VJEÇ NË BASKETBOLL"**

Prof.Dr. Hazir Salihu

Kandidati: Gëzim Elshani

Prishtinë, 2021

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORTS



SUBJECT: BASKETBALL

Topic: PRESENTATION OF CHARACTERISTICS IN SOME DIFFERENT MORPHOLOGICAL AND BASIC AND SPECIFIC MOVEMENTS BETWEEN THE GROUP OF BOYS AND GIRLS AGE 14-15 YEARS OLD IN BASKETBALL

Prof.Dr. Hazir Salihu

Candidate: Gëzim Elshani

Prishtina, 2021

1.HYRJJE	4
1.1.Hulumtimet e deritanishme	5
2.QËLLIMI I HULUMTIMIT	8
3. Hipotezat e hulumtimit	9
4. METODOLOGJIA E PUNËS	10
4.1. Mostra e entiteteve	10
4.2. Mostra e ndryshoreve.....	10
4.2.1. Përshkrimi i instrumenteve matëse	11
4.2.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike.....	12
4.3.2.Përshkrimi i instrumenteve matëse tek ndryshoret lëvizore bazike.....	16
4.3.3.Përshkrimi i instrumenteve matëse të ndryshoreve të motorikës specifike.....	20
5.Metodat e përpunimit të rezultateve.....	24
6. REZULTATET DHE DISKUTIMI.....	25
6.1.Treguesit themelor statistikorë antropometrike dhe motorike vajzat	25
6.2. KORELACIONET E NDRYSHOREVE MANIFESTE.....	26
6.2.1. Korelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike manifeste vajzat.....	26
6.2.2. Korelacionet ndërmjet ndryshoreve motorike manifeste meshkujt.....	29
6.3. KROSKORELACIONET	31

6.3.1. Kroskorelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe motorike vajzat.....	31
6.3.2. Krosorelacionet në hapësirën antropometrike dhe motorike - meshkujt.....	32
6.4. ANALIZA REGRESIVE E MATJEVE TË NXËNËSVE.....	32
6.4.1.Sistemi i ndryshoreve prediktore dhe kriterike per vajzat.....	32
6.4.2. Sistemi i ndryshoreve prediktore dhe kriterik per meshkujt.....	40
6.5 DALLIMET NDËRMJET NXËNËSVE VAJZA DHE MESHKUJ.....	47
6.5.1 T–testi ndërmjet nxënësve vajza dhe meshkuj në hapësirën antropometrike.....	47
7.ANALIZA DHE VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	49
8.PËRFUNDIMI.....	50
9.ABSTRAKTI.....	51
10.BIBLIOGRAFIA	53

1.HYRJE

Sot një ndër sportet më komplekse dhe atraktive është Basketbolli modern, që vjen si rezultat i zhvillimit të koncepteve sistematike nga ana e ekspertëve ndërkombtarë. Ai u jep basketbollistëve të të gjitha niveleve dhe aftësive stërvitjet më të fundit të basketbollit të integruar me forcimin thelbësor, kondicionimin kardiovaskular, shpejtësinë, gatishmërinë dhe fuqinë, të cilat janë të sigurta për të sfiduar çdo atletë mendërisht dhe fizikisht. Secili basketbollistë merr ushtrime të përshtatura për të përmirësuar dobësitë e tyre dhe rregullon mirë pikat e forta.

Në ditët e sotme loja është shumë më e shpejtë dhe të gjithë në ekip duhet të jenë në gjendje të vrapojnë dhe të lëvizin. Gjithnjë e më shumë dominojnë përgatitjet fizike, shpejtësia e reaksionit dhe shpejtësia e aksioneve të sakta dhe precize, forca trupore, si dhe mbrojtjet agresive. Lojtarët e zhvillojnë lojën e tyre, si në sulm ashtu edhe në mbrojtje. Ata i shikojnë lojërat nëpërmjet videove, performancën e tyre, shikojnë kundërshtarët e tyre, shikojnë lojtarët nëpër ligat e ndryshme, qoftë në Evropë apo Amerikë, duke marrë elemente të ndryshme të lojës prej tyre dhe duke i përshtatur në lojën e vet. Në këtë mënyrë lojtarët e shtyjnë njëri-tjetrin për t'u bërë gjithnjë e më të mirë në lojën e tyre. Edhe ekipet zhvillohen në të njëjtën mënyrë. Ekipet e ndryshme ndërrojnë taktikat në sulm apo në mbrojtje për t'ju përshtatur lojtarëve që ata kanë ose lojtarëve kundër të cilëve do të luajnë. Mënyra të reja të lojës, mënyra të reja të zgjidhjes së situatave që ndodhin në parket i shtyjnë trajnerët që të qëndrojnë në hap me lojën. Të rinjtë “vajza dhe djem” të tregojnë interesimin, cilësinë dhe shkathhtësitë në sportin e Basketbollit.

Ky zhvillim konstant i lojës është ajo çfarë basketbolli modern është sot. Të mbajmë sytë hapur, të ndjekim trendët e zhvillimit të lojës, të marrim elemente të ndryshme të lojës dhe t'i zbatojmë nëpër ekipet apo klubet tona, dhe pse jo të gjejmë edhe forma të reja në zhvillim e tyre. Kështu edhe ne do të bëhemi pjesë në zhvillimin e basketbollit modern.

1.1. HULUMTIMET E DERITANISHME

Salihu., H. (2003). Në punimin e tij me titull “Ndryshimet e zhvillimit të veçorive morfologjike dhe aftësive motorike të basketbollistët e rinj”. Punimi i tij ka përfshirë numrin e 161 basketbollistëve të moshës 16 vjeçarë, dhe atë testimin fillestar dhe përfundimtar. Në hapësira morfologjike ka përfshirë (11) teste, ndërsa në hapësirën motorike bazike dhe situacionale ka përfshirë 12 teste, nga testimi fillestar dhe përfundimtar. Nga hapësirat e testeve morfologjike janë fituar tre faktorë, ndërsa tek hapësira e testeve motorike, bazike e situacionale, janë fituar 4 faktorë me rëndësi të vlefshme .

Salihu., H. (2000). Në punimin e tij të magjistraturës ka bërë hulumtimin tek basketbollistët e rinj më titull “Relacionet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike të përgjithshme dhe situacionale tek basketbollistët e rinj“, Prishtinë. Autori ka testuar relacionet e disa karakteristikave trupore dhe aftësive motorike, bazike situacionale tek basketbollistët e moshës 14+ 6 muaj. Si mostër të këtij punimi ka përfshirë 108 basketbollistë të rinj të gjinisë mashkullore, të qytetit të Prishtinës, ku për model të ndryshoreve ka morfologjinë dhe ka aplikuar 10 teste, dhe aftësive motorike situacionale (5) teste, dhe (5) teste tjera nga aftësitë motorike të përgjithshme apo bazike.

Aliu., M (1991) në disertacionin e doktoraturës me temën: „Zhvillimi morfologjik dhe disa karakteristika motorike të popullatës dhe diferenca në ato karakteristika kronologjike të moshës së caktuar“, mostra prej 461 të testuarve ka qenë ndarë në tri submostra (15, 16 dhe 17 vjeçare) në bazë të rezultateve të faktorizimit në hapësirën antropometrike janë izoluar tre dimensione latente antropometrike: *dimensioni i skeletit cirkular, indi dhjamor nënlëkuror dhe dimensionin i skeletit transversal*, ndërsa në hapësirën latente antropometrike, për submostrën 17 vjeçare, janë ekstraktuar 3 faktorë latentë lëvizorë të definuar si: 1. *faktori i ekuilibrit me sy të mbyllur dhe të hapur*, 2. *faktori i sprintit* dhe 3. *faktori i forcës eksplozive*

Rushiti., H. (1999). Në punimin e tij të magjistraturës “Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe relacioni i tyre me disa aftësi motorike te të rinjtë e moshës 13-14 vjeçare”¹, në mostrën prej 205 nxënësve të moshës 13-14 vjeçare , nxënës të shkollave fillore që janë trajtuar me 18 variabla antropometrike dhe 11 ndryshoreve motorike, me faktorizimin e hapësirës antropometrike ekstraktoi 2 faktorë latentë antropometrikë: *faktorin gjeneral morfologjik dhe faktorin e indit dhjamor nënlëkuror.*

Ndërsa në hapësirën lëvizore janë ekstraktuar tre faktorë latentë lëvizorë: *1 .faktor i fleksibilitetit të trupit, 2. faktori i forcës dhe shpejtësisë dhe 3 .faktor i shpejtësisë së frekuencave të dorës dhe kërcimit së gjati nga vendi*

Hasangjekaj., B dhe Kika., XH (1999) në mostrën e 235 nxënësve te shkollave fillore të Prishtinës moshë 11 vjeçare të testuar me 18 variabla antropometrike dhe 8 ndryshoreve motorike, kanë arritur që të definojnë 2 faktorë me vlera të rëndësishme.

Relacioni i qiftit kanonik mes sistemeve morfologjike dhe atij motorik, tregon se nxënësit me grumbullim të indit dhjamor nënlëkuror dhe me dimensione të ultë të skeletit tregojnë rezultate të dobëta në shpejtësi dhe në forcën repetitive. Kurse relacioni i dytë i faktorëve kanonik tregon se nxënësit që nuk i takojnë tipit pikenomorf arrijnë rezultate më të dobëta në ato aktivitete ku dominon forca statike.

Myrtaj., N. (2007), në punimin e tij të magjistraturës :“Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në transformimin e aftësive lëvizore te të rinjtë e moshës 11,12 dhe 13 vjeç”³.

Në këtë punim, është trajtuar popullata e të rinjve, e definuar nga grupe moshat 11,12 dhe 13 vjeç. Gjithsejt janë testuar 140 të rinj të ndarë në dy grupe.

Në këtë punim, autori ka vërtetuar se ekzistojnë ndryshime të rëndësishme brenda grupit përkatës të moshave të ndryshëm

Çitaku., F, (1985), në hulumtimin “Struktura latente e precizitetit” ka bërë hulumtime me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe të Podujevës. Për këtë hulumtim ka pasur gjithsej 32 variabla të precizitetit motorik, ndërsa numri i entiteteve ishte 496 nxënës. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë konstatimi i strukturës primare të precizitetit latent. Në këtë hulumtim është punuar me analizën faktoriale

latente të strukturës së precizitetit, me ç'rast janë vërtetuar tre nivele të strukturës latente të precizitetit.

Rakovica. H(1998) në hulumtimin “Hapësira motorike e fëmijëve të moshës 11 vjeçare dhe faktorizimi i saj”, në mostrën prej 300 hendbollistëve ka trajtuar aftësitë motorike të tyre përmes 14 testeve. Me analizën faktoriale ka ekstraktuar 4 faktorë latentë të hapësirës motorike:

- 1.Faktori i shpejtësisë dhe i forcës.
- 2.Faktori i forcës statike dhe përsëritëse i këmbëve.
- 3.Faktori i lëvizshmërisë së këmbëve.
- 4.Faktori forcës statike dhe përsëritëse të këmbës

Gjinolli. E.(1997), në temën “ Karakteristikat antropometrike të vlefshme për volejball të nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore “ (4) ka bërë hulumtimin duke pasur qëllim thelbësor antropometrinë dhe motoriken me nxënësit me orientim në volejball. Në faktorizimin e hapësirës antropometrike janë izoluar dy dimensione latente antropometrike: në analizën regresive në mostrën e ndryshoreve predikore janë përfshirë 18 variabla antropometrike, kurse në atë motorike 10.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Në bazë të numrit të nxënësve të cilët do të trajtohen në këtë punim, moshës së tyre, gjinisë, tretmanit të ndryshëm sistematik, me këtë edhe numrit të ndryshoreve , qëllimi apo objektivat kryesore të këtij projekti do të përkufizohen në realizimin e këtyre qëllimeve:

Vlerësimi i disa karakteristikave të nivelit morfologjik, aftësive lëvizore bazike dhe specifike të kësaj grupmoshe.

Vlerësimin e ndryshimeve përmes metodës së T-testit, në hapësirën lëvizore ndërmjet dy grupeve përkatëse të nxënësve të të dy gjinive.

Vërtetimin e korrelacioneve të rëndësishme ndërmjet testeve lëvizore-bazike dhe testeve lëvizore tipike për lojën e basketbollit.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe shkencor të ndryshoreve të hulumtuara dhe objektivave primare janë paraparë këto hipoteza themelore:

H1 – Supozojmë se do të paraqiten ndryshime të rëndësishme ndërmjet ndryshoreve morfologjike dhe atyre lëvizore-bazike ndërmjet dy grupeve. duke e aplikuar metodën e T-testit.

H2 – Do të vërtetohet ndikimi i ndryshoreve morfologjike dhe lëvizore bazike specifike përmes analizës regressive në zhvillimin e aftësive lëvizore të të dy grupeve.

H3 – Presim korelacione –lidhmëri të rëndësishme ndërmjet ndryshoreve morfologjike dhe aftësive lëvizore bazike e specifike tek të dy grupet.

4.METODOLOGJIA E PUNËS

4.1 MOSTRA E ENTITETEVE (TË TESTUARVE)

Në këtë projekt do të trajtohen nxënësit e moshës 14-15 vjeç, ku numri i përgjithshëm i tyre do të jetë 61 nxënës, grupi prej 30 nxënësve të gjinisë mashkullore dhe grupi prej 31 nxënësve të gjinisë femërore.

4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE

Mostra e të rinjve në këtë projekt do t'i nënshtrohet procedurave të testimit në kushte të njëjta, para fillimit të orës mësimore. Grupin e parë të ndryshoreve e përbëjnë ndryshoret morfologjike dhe testet e aftësive lëvizore të karakterit bazik, ndërkaq grupin e dytë e përbëjnë variablat specifike tipike të lojës së basketbollit.

1. Ndryshoret morfologjike

Lartësia e trupit

Pesha e trupit

Gjatësia e krahut

Gjatësia e këmbës

2. Ndryshoret lëvizore bazike

Kërcim nga vendi në largësi

Kërcim nga vendi në lartësi

Vrapim 20 metra nga starti i lartë

Hedhja e topit të basketbollit në largësi

3. Ndryshoret specifike

Gjuajtje nga 3 pozicione gjysmë-distanca

Gjuajtje të lira

Gjuajtje nga distanca

Driblimi me top vajtje-ardhje 20 m.

4.3. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE

Këtë punim e kemi realizuar duke ia përshtatur zhvillimit dhe rritjes së nxënësve në këtë moshë, për këtë arsye është përdorur Sistemi Ndërkombëtarë i Kinantropometrisë (ISAK) për të për zgjedhur variablat në hapësirën antropometrike si pjesë e sistemit të standardizuar. Ndërsa në hapësirën motorike është përdorur sistemi i ndryshoreve të standardizuara për lojën e Basketbollit në motorikën bazike dhe motorikën situacionale janë teste.

Në hapësirën antropometrike për këtë punim janë përdorur tetë variabla antropometrike që mendojmë se përfshijnë pjesët kryesore të karakteristikave morfologjike të nxënësve dhe është e mjaftueshme për një punim master për të dy gjinitë e nxënësve, variablat antropometrike janë si në vijim:

4. Ndryshoret morfologjike

Lartësia e trupit

Pesha e trupit

Gjatësia e krahut

Gjatësia e këmbës

5. Ndryshoret lëvizore bazike

Kërcim nga vendi në largësi

Kërcim nga vendi në lartësi

Vrapim 20 metra nga starti i lartë

Hedhja e topit të basketbollit në largësi

6. Ndryshoret specifike

Gjuajtje nga 3 pozicione gjysmë-distanca

Gjuajtje të lira

Gjuajtje nga distanca

Driblimi me top vajtje-ardhje 20 m.

4.3.1.Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

➤ Lartësia e trupit

Ndryshorja e lartësisë së trupit është realizuar duke përdorur antropometri sipas Martinit. Nxënësit gjatë realizimit të matjeve kanë qenë të zbathur dhe me veshje sportive, ata kanë qëndruar në këmbë paralel në bazën e fortë horizontale. Koka e nxënësit ishte në pozitë, dhe vija e cila e bashkon skajin e sipërm të zgavrës së jashtme të organit të dëgjimit, duhet të jetë në horizontale me skajin e poshtëm të zgavrës së syrit (rrafshi i Frankfurtit). Nxënësit duhet drejtuar shpinën aq sa është e mundur. Profesori që bën matjen qëndron afër të maturit dhe e kontrollon se a është vënë antropometri saktësisht përgjatë anës së prapme dhe vertikalisht, pastaj e zbrit krahun e antropometrit që është horizontalisht, deri sa ai të prekë kokën e të maturit. Rezultati lexohet prej 0.1 cm.



Foto1

➤ Pesha e trupit

Pesha e trupit është matur me peshojë decimale lëvizëse, e cila mundëson saktësinë e matjës prej 0.1 kg. Peshoja është domosdoshme të vëhet në pozitë horizontale, dhe për çdo ditë para përdorimit dhe pas 10 matjeve të bazhdarohet. I maturi është i zbathur, në brekë të shkurtër, qëndron në këmbë të qetë në mes të peshojës. Pasi që treguesi të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi 0.1 kg.



Foto 2

➤ Gjatësia e krahut

Ndryshorja e gjatësisë së krahut tek nxënësit është matur duke e përdorur antropometrinë e shkurtuar. Nxënësi ka qëndruar në këmbë, me trup të drejtë, dora është e shtrirë. Njëri skaj i antropometrit është i vendosur në kokë të humerusit, ndërsa skaji tjetër vendoset në artikulationin ndërmjet humerusit dhe ulna-s. Rezultati lexohet i saktë prej 0.01 cm.



Foto 3

➤ Gjatësia e këmbës

Ndryshorja e gjatësisë së këmbës tek nxënësit është matur duke e përdorur antropometrin sipas Martinit. Nxënësi ka qëndruar me trupin drejtë sikurse tek matja e lartësisë së trupit. Realizimi matjes është bërë dysHEMEJA ku qëndron nxënësi i zbathur deri në pikën e quajtur “spina iliaca anterior superior” të anës së majtë, e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit. Rezultati lexohet saktë 0.1 cm.



Foto 4

4.3.2.Përshkrimi i instrumenteve matëse tek ndryshoret lëvizore bazike

➤ Kërcim nga vendi në largësi

Për të realizuar testin e kërcimit së largu janë përdorur mjetet: Tre dyshek gjimnastikorë të trashësisë 5-7 cm, pedana standarte, magnesium dhe metri metalik.Udhëzim: Një metër pranë dyshekëve gjimnastikorë është e vendosur pedana e kthyer nga pjesa e përparme, ndërsa dyshekët janë të mbështetur me njërin skaj në mur për të mos rrëshqitur. Para kërcimit subjekti i lyen këmbët me magnesium. Procedurat: Subjekti kërcen duke u shtyerë me të dy këmbët, nga pjesa e përparme e pedanës,dhe bie në dyshek sa më larg që mundet. Gjatë shtytjes lejohet hovi me krahë, por shtytja dhe rënia duhet të bëhet më dy këmbët. Regjistrohet distanca nga vija shtytëse deri te gjurma më e afërt në dyshek. Testi përsëritet 3 herë dhe shënohet rezultati më i mirë.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.



Foto 5

➤ **Kërcim nga vendi në lartësi**

Për të realizuar testin e kërcimit së largu janë përdorur mjetet Mjetet: Shiriti metrik, një asistent. Udhëzim: I testuari në fillim duhet të ofrohet afër murit, ku është i ngjitur shiriti milimetrik, pozicioni është në drejtkëndrim i kthyer anash murit, krahun afër me murin duhet ngritur lartë afër shiritit në majën ku prekë gishti më i gjatë i dorës shënohet vlera e lartësisë fillestare. Procedura: Subjekti duke u përkulur në gjunjë dhe duke e shfrytëzuar hovin e krahëve shtyhet lart dhe takon pikën më të lartë të mundëshme në shiritin milimetrik. Vlera regjistrohet dhe nga kjo vlerë zbritet vlera e lartësisë fillestare. Diferenca në mes këtyre vlerave shënon vlerën e kërcimit nga vendi në lartësi. Subjekti ekzekuton tri tentime dhe shënon rezultatin më të mirë. Vlera shënohet me saktësi prej 0.1 cm



Foto 6

➤ Vrapim 20 metra nga starti i lartë

Për të realizuar Testin e vrapimit 20 metra starti i lartë, është realizuar në sallën e sportit të shkollës në të cilën është vijuar mësimin shtegun e shënuar të gjatë prej 20 metra nga vija e nisjes deri të vija e cakut. Gjërësia e shtegut është 1.20m. Nxënësi nga pozita e nisjes starti i lartë, pas komandës “gati” dhe sinjalit për nisje, vrapon me shpejtësi maksimale distancën prej 20m. Koha matet nga momenti i sinjalit për nisje e derisa vrapuesi të kalojë me gjoks rrafshin vertikal mbi vijën e cakut. Rezultati shënohet saktë prej 0.1 sec.



Foto 7

➤ Hedhja e topit të basketbollit në largësi

Për të realizuar Testin e hedhjes së medicinbollit, është përdorur salla e sportit të shkollës në të cilën është vijuar mësiminxënësi ka qëndruar në këmbë më dy këmbët paralel dhe e ka hedhur topin me aq fuqi sa ka pasur. Gjatë matjes, njëri matës qëndron afër cakut e përcjell ku po bien topi afër shiritit matës. Procedurat: Subjekti qëndron me dy këmbë paralel, i i vendosur mirë duke mbajtur topin e basketbollit, në duar afër gjoksit, ndërsa metri vendoset nga gishtërinjtë e këmbëve të subjektit dhe shtrihet para, subjekti e hedh topin sa më larg që mundet, gjatë hedhjes trupi është i mbështetur në të dy këmbët i cili nuk guxon të largohet nga karriga. Subjekti ekzekuton tri tentime dhe shënon rezultatin më të mirë. Vlera shënohet me saktësi prej 1 cm.



Q Foto 8

4.3.3.Përshkrimi i instrumenteve matëse të ndryshoreve të motorikës specifike

➤ Gjuajtje nga 3 pozicione gjysmë-distanca

Për të realizuar testin e gjuajtjes nga 3 pozicione të gjysëm distancës, testi është realizuar në sallën e sportit në shkollë duke pikëtuar tre pozicione në gjysëm distancë dhe gjuajtja e topit në kosh është bërë në mënyrë që nxënësi vendoset afër piketës dhe nga ana e djathtë, ana e majtë dhe përballë koshit janë realizuar tre gjuajtjet në kosh, largësia e nxënësit nga caku është 3 metra dhe numri i gjuajtjeve është 5 here ndërsa për rezultat mirren numri i shënimeve në kosh.



Foto 9

➤ Gjuajtje të lira

Për të realizuar testin e gjuatjes së lirë, atëherë testi është realizuar në sallën e sportit në shkollë. Nxënësi vendoset në hapësirën për gjuajtje të lira dhe e ekzekuton gjuajtjen me dorën në të cilën e preferon nxënësi në mënyrë që të testohet saktësia e gjuatjes së lirë të topit në kosh kjo gjuajtje perseritet 5 here dhe mirret rezultati i shënimeve të koshit.



Foto 10

➤ Gjuajtje nga distanca

Për të realizuar testin e gjuajtjes nga distanca, atëherë testi është realizuar në sallën e sportit në shkollë. Gjuajtjet nga distanca në kosh bëhet në këtë mënyrë , nxënësin e vendosim në hapësirën nga distanca për gjuajtje, numri i gjuajtjeve bëhet nga 5 here dhe praktika e gjuajtjeve bëhet në vende të ndryshme rreth hapësirës për gjuajtje, për shënimet e sakta mirret rezultati më i mirë.



Foto 11

➤ Driblimi me top vajtje-ardhje 20 m.

Për të realizuar testin e driblimit me top vajtje ardhje, ky test gjithëashtu është realizuar në sallën e sportit të shkollës, ku nxënësi ka udhëhequr me top në fushë që bëhet në gjatësi të fushës së basketbollit. Udhëheqja bëhet në drejtim drejtvizorë të fushës së basketbollit . Nxënësi fillon me shënjen “tash” duke e udhëhequr topin drejt, duke dribluar me top vajtje dhe ardhje. Matet koha e nisjes me kronometër deri te kalimi i lojtarit dhe topit në cak vajtje ardhje . Testi përsëritet tre herë dhe mirret rezultati më i mirë.



Foto 12

5. METODA E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Bazuar në qëllimin primar të punimit dhe hipotezave të parashtruara, në këtë hulumtim do të aplikohen metodat e përpunimit të të dhënave, të cilat do të mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit, duke shfrytëzuar programe adekuate për përpunimin e të dhënave.

Për të dy grupet e sistemit të ndryshoreve do të llogariten ndryshoret themelore statistikore dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë.

Për vërtetimin e ndryshimit të moshave dhe grupeve do të aplikohet metoda e T-Testit ndërmjet dy grupeve .

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit. Për të dy grupet e sistemit të ndryshoreve do të llogariten parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën ndryshore, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

Parametrat themelor statistikor:

Vlerat minimale dhe maksimale (R.min-R.max)

Mesatarja aritmetikore (Ma)

Devijimi standard (Ds)

Parametrat e asimetrisë (SKEË dhe KURT)

Korelacioni

T-Testi

Analiza regresive

6.REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tabela 1.Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike dhe motorike – vajzat

Ndryshoret	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skeëness	Kurtosis
Larttr	31	151.2	173.9	163.0903	4.93662	-0.019	0.491
Peshtr	31	34.3	93.9	58.5323	11.6722	0.9	2.242
Gjatkra	31	66.2	84.3	76.1226	5.36909	-0.444	-0.935
Gjatkem	31	94.6	109.8	100.6484	3.37489	0.495	0.552
Kercgjat	31	71.6	166.9	128.8	20.76784	-0.439	0.547
Kerclart	31	12.4	37.6	28.4452	5.65172	-1.148	1.776
Vrap20m	31	3.6	5.74	4.2523	0.57272	1.325	1.179
Hedhtop	31	6.46	9.76	7.8781	1.00619	0.283	-1.31
Gjuuajtj3x2	31	0	4	1.7742	1.02338	0.287	0.058
Gjuajlire	31	0	5	2.3548	1.40353	0.086	-0.719
Gjuajtdist	31	0	3	0.6774	0.79108	1.095	0.997
Dribvajardh	31	10	16.06	12.489	1.53413	0.446	-0.238

Në këtë punim janë aplikuar katër ndryshore antropometrike dhe tetë ndryshore të motorikës bazike dhe motorikës specifike, për të cilat mendohet se janë parametra të rëndësishëm për këtë punim. Në tabelën nr. 1. janë paraqitur rezultatet themelore statistikore të 31 nxëneseve vajza në hapësirën antropometrike dhe motorike. Rezultatet e paraqitura në këtë tabelë janë : numri i individëve, rezultati minimal (minumum), maksimal (maximum) mesatarja aritmetikore (mean) , devijimi standard (std. deviation), masat e asimetrisë (skeëneës dhe kurtosis). Në bazë të rezultateve të fituara në tabelën nr. 1. në mes të rezultateve minimale dhe maksimale të reflektuara nga devijimi standard, vlerat janë paraqitur në suaza të normales si në hapësirën antropometrike poashtu edhe në atë motorike për arsye se kemi të bëjmë me një grup të seleksionuar dhe homogjen përveq ndryshores së kërcimit së gjati e cila tregon për një devijim më të theksuar në vlerë prej (.20.767) . Ndërsa rezultatet e masave të asimetrisë, kemi një paraqitje homogjene në aspektin e shtrirjes së rezultateve.

Tabela 2. Treguesit themelore statistikore në hapësirën antropometrike dhe motorike – meshkujt

Descriptive Statistics

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skeëness	Kurtosis
Larttr	30	152.4	203.8	174.25	10.12977	0.411	1.381
Peshtr	30	42.5	88.3	61.77	12.38334	0.367	-0.79
Gjatkra	30	65.1	105.2	81	7.50352	0.768	2.899
Gjatkem	30	92.8	128.8	107.77	7.12321	0.59	1.596
Kercgjat	30	114.1	214.5	164.96	26.29861	0.286	-0.506
Kerclart	30	20.2	52.1	38.03	8.03231	-0.19	0.005
Vrap20m	30	3.2	4.73	3.817	0.39159	0.53	-0.015
Hedhtop	30	7.2	14.54	10.6293	1.83766	0.571	-0.114
Gjuuajtj3x2	30	0	4	1.6333	1.27261	0.218	-1.099
Gjuajlire	30	0	4	2.2	0.96132	-0.18	-0.309
Gjuajtdist	30	0	3	1.1667	0.91287	0.523	-0.298
Dribvajardh	30	8.41	14.8	10.2293	1.61066	1.115	0.737

Në tabelën nr. 2. janë paraqitur rezultatet themelore statistikore të 30 nxënësve meshkuj në hapësirën antropometrike dhe motorike. Rezultatet e paraqitura në këtë tabelë janë : numri i individëve, rezultati minimal (minimum), maksimal (maximum) mesatarja aritmetikore (mean), devijimi standard (std. deviation), masat e asimetrisë (skeëneës dhe kurtosis). Në bazë të rezultateve të fituara në tabelën nr. 2. në mes të rezultateve minimale dhe maksimale të reflektuara nga devijimi standard, vlerat të cilat duhet theksuar në hapësirën antropometrike janë ato të peshës së trupit që ka devijim standard prej (10.129) dhe peshës së trupit e cila tregon për devijim në vlerë prej (12.383) poashtu edhe në hapësirën motorike për arsye se kemi të bëjmë me një grup të seleksionuar dhe homogjen të gjitha ndryshoret tregojnë vlera të përafërta përveq ndryshores së kërcimit së gjati e cila tregon për një devijim më të theksuar në vlerë prej (26.298). Ndërsa rezultatet e masave të asimetrisë, kemi një paraqitje homogjene në aspektin e shtrirjes së rezultateve.

6.2. KORELACIONET E NDRYSHOREVE MANIFESTE

6.2.1 Korelacionet në hapësiren antropometrike dhe motorike - vajzat

Tabela nr:3 Korelacionet në hapësiren antropometrike - vajzat

Ndryshoret	Larttr	Peshtr	Gjatkra	Gjatkem
Larttr	1			
Peshtr	.499**	1		
Gjatkra	.365*	0.19	1	
Gjatkem	.582**	0.319	-0.106	1

Në tabelën 3 është dhënë tabela me rezultatet korelative ndërmjet ndryshoreve në hapësiren antropometrike të nxënëseve vajza. Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelë mund të themi se në këtë tabelë të korelacioneve të ndryshoreve antropometrike janë fituar rezultate të larta dhe të vlefshme vetëm nga ndryshorja në hapësiren antropometrike e lartësisë së trupit me peshën e trupit në vlerë prej .499**, me gjatësinë e krahut në vlerë prej .365* dhe me gjatësinë e këmbës në vlerë prej .582**.

Tabela nr:4Korelacionet në hapësiren motorike - vajzat

Ndryshoret	Kercgjat	Kerclart	Vrap20m	Hedhtop	Gjuajtj3x2	Gjuajlire	Gjuajtjdist	Dribvajardh
Kercgjat	1							
Kerclart	.507**	1						
Vrap20m	-.514**	-.414*	1					
Hedhtop	.519**	0.205	-0.194	1				
Gjuajtj3x2	0.328	.360*	-0.123	0.326	1			
Gjuajlire	.368*	.374*	-0.231	.425*	0.313	1		
Gjuajtjdist	0.240	0.314	-0.267	.486**	0.154	0.347	1	
Dribvajardh	-.438*	-0.210	0.225	-.415*	-0.300	-0.215	-0.270	1

Në tabelën 4 është dhënë tabela me rezultatet korelative ndërmjet ndryshoreve në hapësiren e motorikës bazike dhe motorikës specifike të nxensëve vajza. Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelë mund të themi se në këtë tabelë të korelacioneve të ndryshoreve motorike janë fituar rezultate të larta dhe të vlefshme vetëm nga disa ndryshore në hapësiren motorike sic janë e kercimit së gjati me kercimit së larti në vlerë prej .507**, me vrapim 20 metra në vlerë prej . - .514**, me testin e hedhjes së topit në vlerë prej .519**, me testin gjuajtjes se lire .368* dhe me testin e driblimit vajtje ardhje në vlerë prej -.438**, gjithëashtu ndryshorja e hedhjes së topit ka treguar korrelacion me testin e gjuajtjes së lirë në vlerë prej .425**, gjuajtje nga distanca .486 dhe driblim vajtje ardhje -.415*.

6.2.2 Korelacionet në hapësiren antropometrike dhe motorike - meshkujt

Tabela nr:5 Korelacionet në hapësiren antropometrike - meshkujt

Ndryshoret	Larttr	Peshtr	Gjatkra	Gjatkem
Larttr	1			
Peshtr	.548**	1		
Gjatkra	.714**	0.315	1	
Gjatkem	.900**	.367*	.812**	1

Në tabelën 5 është dhënë tabela me rezultatet korelative ndërmjet ndryshoreve në hapësiren antropometrike të nxënësve meshkuj. Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelë mund të themi se në këtë tabelë të korelacioneve të ndryshoreve antropometrike janë fituar rezultate të larta dhe të vlefshme në hapësiren antropometrike, e sidomos nga ndryshorja e lartësisë së trupit me peshën e trupit në vlerë prej .548**, me gjatësinë e krahut në vlerë prej .714** dhe me gjatësinë e këmbës në vlerë prej .900**. Po ashtu edhe ndryshorja e gjatësisë së këmbës ka treguar lidhje të vlefshme me peshën e trupit në vlerë prej .367* dhe me gjatësinë e krahut në vlerë prej .712**.

Tabela nr:6 Korelacionet në hapësiren motorike - meshkujt

Ndryshoret	Kercgjat	Kerclart	Vrap20m	Hedhtop	Gjuuajtj3x2	Gjuajlire	Gjuajtjdist	Dribvajardh
Kercgjat	1							
Kerclart	.682**	1						
Vrap20m	-.678**	-.558**	1					
Hedhtop	.548**	0.313	-.450*	1				
Gjuuajtj3x2	0.091	-0.039	-0.023	0.260	1			
Gjuajlire	0.116	0.068	0.114	0.284	-0.051	1		
Gjuajtjdist	0.096	0.013	0.049	0.233	.470**	0.196	1	
Dribvajardh	-.550**	-0.312	.601**	-.420*	0.009	-0.063	0.000	1

Në tabelën 6 është dhënë tabela me rezultatet korelative ndërmjet ndryshoreve në hapësiren motorikës bazike dhe motorikës specifike të nxënsëve meshkuj. Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelë mund të themi se në këtë tabelë të korelacioneve të ndryshoreve motorike janë fituar rezultate të larta dhe të vlefshme vetëm nga disa ndryshore në hapësiren motorike sic janë e kercimit së gjati me kercimit së larti në vlerë prej .682**, me vrapim 20 metra në vlerë prej .-.678**, me testin e hedhjes se topit në vlerë prej .548**, me testin driblim vajtje ardhje -.550**, gjithëashtu ndryshorja e kërcimit së larti ka treguar korrelacion me testin e vrapimit 20 metra ne vlerë prej -.558**, testi i vrapimit 20 metra me testin e hedhjes së topit në vlerë prej -.450* dhe testin driblim vajtje ardhje në vlerë prej .601**.

6.3.KROSKORELACIONET NË MES TË VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE DHE ATYRE SITUACIONALE

6.2.3Krosorelacionet në hapësiren antropometrike dhe motorike - vajzat

Tabela nr:7Kroskorelacionet ndërmjet hapësires antropometrike dhe motorike-vajzat

Ndryshoret	Larttr	Peshtr	Gjatkra	Gjatkem
Kercgjat	-0.059	-.397*	-0.177	-0.028
Kerclart	0.166	-.398*	-0.031	0.021
Vrap20m	-0.172	.440*	-0.180	0.006
Hedhtop	0.259	0.107	-0.109	0.307
Gjuuajtj3x2	-0.112	-0.246	-.416*	0.014
Gjuajlire	.420*	0.025	-0.110	0.114
Gjuajtdist	0.277	-0.131	0.033	0.126
Dribvajardh	-0.040	0.352	0.041	-0.321

Në tabelën nr. 7 . është dhënë tabela e kroskorelacioneve të variablave antropometrike me ato motorike dhe motorikes situacionale tek vajzat. Në këtë tabelë janë paraqitur vlerat kroskorelative ndërmjet hapësirës antropometrike e cila i ka katër ndryshore me hapësirën motorike dhe motorikës situacionale e cila përbëhet prej tetë ndryshoreve.

Duke analizuar amëzën e kroskorelacioneve, vlerat e fituara janë të një niveli të mesëm i propabilitetit, të cilat dallohen në grupime të shkallës së kroskorelacioneve. Në hapësirën antropometrike vlera të larta kroskorelative ka dhënë variabla lartësisë së trupit me ndryshoren e gjuatjes së lirë në vlerë prej .420*, pesha e trupit ndryshoret e forcës eksplozive testin kërcim se gjati -.397*, kërcim së larti -.398*, vrapim 20m .440* dhe driblim vajtje ardhje .362*, gjatësia e krahut me testin e gjuajtjes së 3x2 në vlerë -.416.

6.2.4 Krosorelacionet në hapësirën antropometrike dhe motorike - meshkujt

Tabela nr:8 Kroskorelacionet ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike-meshkujt

Ndryshoret	Larttr	Peshtr	Gjatkra	Gjatkem
Kercgjat	0.121	-0.192	0.042	0.094
Kerclart	0.160	-0.156	0.116	0.099
Vrap20m	-0.011	.452*	-0.066	-0.112
Hedhtop	.359*	0.130	0.261	.375*
Gjuajtje3x2	.521**	0.284	0.151	.389*
Gjuajlire	0.145	0.272	0.139	0.051
Gjuajtdist	.598**	0.287	.473**	.489**
Dribvajardh	0.058	.374*	-0.234	-0.152

Në tabelën nr. 8 . është dhënë tabela e kroskorelacioneve të variablave antropometrike me ato motorike dhe motorikës situacionale tek meshkujt. Në këtë tabelë janë paraqitur vlerat kroskorelative ndërmjet hapësirës antropometrike e cila i ka katër ndryshore me hapësirën motorike dhe motorikës situacionale e cila përbëhet prej tetë ndryshoreve.

Duke analizuar amëzën e kroskorelacioneve, vlerat e fituara janë të një niveli të mesëm i propabilitetit, të cilat dallohen në grupime të shkallës së kroskorelacioneve. Në hapësirën antropometrike vlera të larta kroskorelative ka dhënë variabla lartësisë së trupit me ndryshoren e hedhjes se topit në vlerë prej .359*, me gjuajtjen 3x2 .521** dhe me gjuajtjen në distancë .598**, pesha e trupit ndryshoret e forcës eksplozive testin vrapim 20metra -.452*, dhe driblim vatje ardhje .374**, Ndryshorja e gjatësisë së krahut me testin e gjuajtjes në distancë në vlerë .473 dhe gjatësia e këmbës me testin gjuajtje 3x2 në vlerë prej .389* dhe testin gjuajtje në distancë në vlerë .489**.

6.4.ANALIZA REGRESIVE E MATJEVE TË NXËNËSEVE

6.4.1 Sistemi i ndryshoreve prediktore dhe kriterik për vajzat

Duke u bazuar në problemin, qëllimin dhe hipotezat e parashtruara në këtë punim kemi përdorur analizën regresive për të treguar ndikimin që kanë variablat antropometrike si prediktore tek nxënëset - vajza në realizimin e testeve motorike të përfshira në punim. Gjithashtu mund të parashikojmë se në qfare mase mund të ndikojnë variablat antropometrike prediktore në rezultatet në raport me sistemin e variablave kriterie motorike.

Më poshtë kemi paraqitur tabelat e para me elementet kryesore të analizës regresive të matjeve të nxënësve meshkuj si vijon: Korrelacioni i shumëfishtë (R) i cili tregon vlerën e korrelacionit ndërmjet të gjitha variablave prediktore dhe asaj kriterie. Koeficienti i determinacionit (Adjusted R square), e cila tregon përqindjen e variancës së përbashkët në mes të variablave prediktore dhe asaj kriterie. Vlefshmëria (Sig F change), e cila tregon vlefshmërinë statistikore në nivelin e besueshmërisë .01.

Për të parë në mënyrë më detale relacionet dhe përcaktimin e ndikimit parcial të variablave prediktore në kriter janë paraqitur edhe vlerat e Koeficientet parcial **BETA** dhe korelacioni parcial **Part**, i cili paraqet korrelacionin parcial në mes të variablës prediktore dhe variables kriterie pasi të jetë eliminuar ndikimi i të gjitha variablave tjera .

Duke u bazuar në rezultatet e tabelave të paraqitura më poshtë mund të vërejm se sistemi i variablave antropometrike si prediktorë kanë ndikim në realizimin e variablave motorike si vijon:

Në tabelën nr:9. janë paraqitur vlerat, e cila si kriter është marrë ndryshorja e lartësisë së trupit me dimensionet motorike bazike dhe motorikes specifike të sistemit prediktor antropometrik të variablave kriterike.Me bazë të koeficientit të korelacionit të shumëfishtë ($R_o = 0.640$) mund të shpjegohet 64 % e variabilitetit të përbashkët të sistemit prediktor dhe ndryshores kriterike.Pjesa tjetër e mbetur 36 % është nën ndikimin e faktorëve të panjohur dhe të pa përfshirë në këtë punim.

Poashtu edhe në tabelën nr. 10. Anova ka vërtetuar nëpërmjet korelacionit parcial se variabla kriterike nuk është e rëndësishme së lartë për sistemin prediktorë motorike në vlerë prej Sig. **.110**.

